



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 6802 /2018

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike 03/L-048 neni 45.4, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit neni 75, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.08.2018 merr:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË SHPENZIMEVE BUXHETORE PËR PERIUDHËN JANAR-QERSHOR PËR VITIN 2018

I

Kuvendi i komunës miratoi vendimin për raportin e shpenzimeve buxhetore për periudhën Janar - Qershor për vitin 2018.

II

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është raporti i shpenzimeve buxhetore për periudhën Janar- Qershor 2018 i hartuar nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa. Buxheti i miratuar për vitin fiskal 2018 është në shumë prej 2,766,745.00 €, ndërsa ai përfundimtar është 2,948,262.77 €, duke përfshirë bartjen e mjeteve të pashpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit 2017 në shumë prej 181,517.77 €. Në kategorinë paga dhe mëditje janë shpenzuar 719,400.65 € apo 49.81 %, për mallra dhe shërbime 79,585.70 € apo 34.65 %, për shpenzime komunale 21,381.15 € apo 48.01 %, për subvencione dhe transfere 29,635.80 € apo 56.13 % dhe për shpenzime kapitale 47,235.10 € apo 4.01%. Totali i shpenzimit është në shumë prej 897,238.40 € apo 30.43 %.

III

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës – MAPL-së dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

IV

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Shërbimi i Arkivit.

Hani i Elezit
Data: 30.08.2018

